



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr._____, datë____.____.2025

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 34/2019
“PËR ADMINISTRIMIN E PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË
KONFISKUARA”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, me propozim të Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

VENDOSI:

Në ligjin nr. 34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është miradministrimi dhe përdorimi sa më eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet e drejtësisë ose pasurive të sekuestruara e të konfiskuara nga organet administrative dhe pushteti vendor, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.”

Neni 2

Në nenin 2, pas shkronjës “j”, shtohet shkronja “k” me këtë përmbajtje:

“k) “Fondi i posaçëm i dedikuar për ndërtimet pa leje” janë burime financiare të cilat do të destinohen për veprimtarinë apo zhvillimin e objekteve pa leje, të cilat janë konfiskuar dhe i kanë kaluar në administrim AAPSK-së sipas përcaktimeve ligjore.”

Neni 3

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

“Neni3

Objekti

Ky ligj përcakton rregullat, procedurat dhe strukturën administrative për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet e drejtësisë, organet administrative dhe të pushtetit vendor, si dhe ruajtjen e provave materiale, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.”.

Neni 4

Në nenin 4, pas shkronjës “d”, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:

“dh) pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara nga organet administrative edhe organe të pushtetit vendor.”

Neni 5

Në nenin 7, pas shkronjës “c” të pikës 4, shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) Fondin e posaçëm të dedikuar për ndërtimet pa leje.”

Neni 6

Në nenin 8, shkronja “dh” ndryshohet si vijon:

“dh) kryen procedurat e shitjes, për pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara, të cilat ka në administrim.”

Neni 7

Në nenin 9 bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “f” e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

“f) negociacion dhe lidh kontratat e shitjes, qirasë, huapërdorjes dhe enfiteozës për pasuritë e sekuestruara e të konfiskuara;”

Neni 8

Në nenin 20 bëhen ndryshime dhe shtesa si vijon:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Shtohen pika 4 dhe 5 me këtë përmbajtje:

“4. AAPSK menaxhon monedha virtuale të sekuestruara ose të konfiskuara nga organet e drejtësisë sipas vendimit të gjykatës apo urdhërit të prokurorit, i cili administrohet zyrtarisht në institucion.”

“5. Rregullat dhe procedurat e administrimit të monedhave virtuale, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 9

Në pikën 3 të nenit 21, pas fjalës *“sequestruar”* shtohen fjalët *“dhe/ose konfiskuar”*.

Neni 10

Në pikën 1 të nenit 23, pas fjalëve *“...të vendimit të gjykatës”* shtohen fjalët *“apo të akteve administrative.”*

Neni 11

Në nenin 30, bëhen shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Në pikën 2, pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) çdo shpezim tjetër të domosdoshëm për administrimin e pasurive të konfiskuara si ndërtim pa leje.”

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Procedurat e kryerjes së shpenzimeve për pasuritë e konfiskuara, realizohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.” Për pasuritë në masë “sequestro”, shpenzimet për administrim realizohen mbështetur në studim tregu”.

Neni 12

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që të nxjerrin aktet nënligjore, në zbatim të nenit 9 pika 5, të këtij ligji, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 13

Hyrja në fuqi.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Niko Peleshi